



Regjistri i fermerit, instrumenti i ri që nxit formalizimin dhe sigurinë ushqimore

Faqe 11



Denaj dhe Kumbaro prezantojnë Strategjinë për Agroturizmin: Mbështetje zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit

Faqe 6



4 mijë fermerë më shumë të siguruar, skemat mbështetëse po nxisin sektorin drejt formalizimit

Faqe 6



# AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 472  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

15-ditëshi i dytë i muajit tetor 2023

# PROGRAMI "ULLIRI DHE CILËSIA E VAJIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI"

## KONFERENCA E VAJIT TË ULLIRIT: SHQIPËRIA SYNON TË KONSOLIDOJË MARKËN, PËR TË RRITUR EKSPORTET

Konferenca "Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri, Shtator 2023-2024" organizuar nga KASH, RisiAlbania, MBZHR dhe aktorë të linjës, në kuadër të Panairit Ndërkombëtar "Agrotech Expo 2023" në Tiranë, prezantoi situatën aktuale ku ndodhet sektori sot dhe parashtrori prioritetet për kapërcimin e sfidave në zhvillimin e sektorit sipas standardeve dhe zgjerimin e eksporteve

### RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Joss: Duhet të brendojmë vajin e ullirit për të theksuar vlerën e vërtetë të tij



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



Konferenca e vajit të ullirit, Denaj: Nxitje prodhimit me standarde



Faqe 4

### BIMËT MJEKSORE

Forumi për Cilësinë dhe Standardet në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike: Një Hap Drejt Zhvillimit të Industrisë Shqiptare

Faqe 4

### KËNDI I EKSPERTIT

- IPARD II, 485 kontrata aktive në vlerë prej 83.6 milionë euro kontribut Fq.2
- Ministria e Bujqësisë bisedë me studentë të Universitetit të Tiranës mbi efektet e ndryshimeve klimatike Fq.7
- Drejt përfundimit vjelja e qepës, prodhim cilësor i kësaj kulture në Maliq Fq.10
- Kalendari bujqësor, muaji nëntor 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13



Faqe 2

### AGROTURIZËM

RisiAlbania mbështet webinarin mbi Turizmin e Qëndrueshëm

Faqe 2

# Joss: Duhet të brendojmë vajin e ullirit për të theksuar vlerën e vërtetë të tij

**T**ema mbi cilësinë e vajit të ullirit në Shqipëri bëri bashkë më 20 tetor, ekspertë, akademikë përfaqësues nga Institucionet



Stephan Joss  
Drejtor Projekti

publike dhe private të industrisë së vajit të ullirit në vendin tonë, ekspertë të fushës, bizneset private, të rinj, media dhe përfaqësues të projekteve për ullirin. Konferenca e Vajit të Ullirit iu kushtua përpjekjeve që duhen bërë mbi baza shkencore, në të gjithë zinxhirin e sektorit, për konsolidimin e markës për të rritur eksportet e vajit të ullirit.

Stephan Joss drejtues i projektit të RisiAlbania gjatë fjalës së tij tha se, ndryshimet klimatike ndikojnë në tregje. Spanja u godit rëndë nga rritja e çmimit të vajit të ullirit,

pasi ndryshimet klimatike po dëmtojnë prodhimin. Fermerët e ullirit në Pulia përballen me të vjela katastrofike pas stuhisë së Vjeshtës. Kjo situatë ka ndihmuar në eksportet e vajit nga Shqipëria, por duhen zgjidhje afatgjata që vendi ynë të vendoset në hartë”.

“Dua të nis me ndryshimet klimatike. Kur ministria na kontaktoi për këtë çështje, Spanja dhe Italia në atë kohë po vuanin nga një thatësi që kishte dëmtojtuar prodhimin e tyre të ullirit. Kur ministria na kontaktoi, kërkoi që ne të gjejmë një zgjidhje afatgjatë dhe jo vetëm për një vit, pasi Shqipëria fatmirësisht nuk u përball me fatkeqësi të tilla. Ne si eksportues duhet të përgatitemi për situata të paparashikueshme, si për tregun vendas ashtu edhe për atë të huaj. Ne duhet të shohim potencialin e vërtetë të këtij produkti. Duhet të brendojmë dhe të vendosim një imazh të vajit të ullirit për të theksuar vlerën e vërtetë, por duhet të rritet besimi të konsumatorit dhe kjo bëhet vetëm duke menaxhuar cilësinë. Është e vërtetë që duhet të investohet në pajisje, por fitimet e marra pas rritjes së cilësisë do të jenë gjithmonë e më të shumta. Bashkimi i të gjitha këtyre na vendos në hartë me

shtetet e tjera, duke na bërë të barabartë dhe duke konkurruar denjësisht me Spanjën, Italinë dhe Greqinë.” - u shpreh Joss.

Joss u ndal tek rëndësia e sistemeve të menaxhimit të cilësisë, ku përmendi: Ndryshueshmërinë e reduktuar; Efikasitetin dhe reduktimin e kostos; Përmirësimin e vazhdueshëm; Menaxhimin e risikut; Përgjegjësinë mjedisore; Pajtuëshmërinë me rregulloret; Rritjen e reputacionit; Gjurmueshmërinë; Besimin dhe sigurinë e konsumatorit; Konkurrueshmërinë.

Falë përpjekjeve të aktorëve të linjës, KASH-it, autoriteteve të MBZHR dhe mbështetjes së donatorëve, RisiAlbania, Shqipëria mund të kthehet në një vend konkurrues sa i takon prodhimin dhe eksportin të vajit të ullirit në tregjet ndërkombëtare por për këtë i duhet të konsolidojë markën e saj. Vetëm këtë 8-mujor eksportet kapën vlerën e 25 milionë eurove, me rritje vjetore gati 7 herë më të lartë në raport me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Me një traditë të gjatë në kultivimin e ullirit dhe prodhimin të vajit, vëmendja e re që ka marrë sektori dhe investimet, po e bëjnë gjithmonë e më të prekshëm zgjerimin në tregje të reja.

# IPARD II, 485 kontrata aktive në vlerë prej 83.6 milionë euro kontribut

Programi IPARD II 2014 – 2020 ka filluar në vitin 2018 dhe deri më tani janë nënshkruar 485 kontrata aktive në vlerë prej 83.6 milionë euro

bërë në arritjen e objektivave të përcaktuar në këtë program. Ky Komitet përbëhet nga shoqata dhe grupe të tjera interesi që operojnë në fushën

zbatimin e Programit IPARD II, si: sistemi i menaxhimit dhe kontrollit të IPARD, zbatimin e programit IPARD II, aktivitetet që janë zhvilluar në lidhje me komunikimin dhe vizibilitetin e Programit IPARD II, progresi në përcaktimin e aktiviteteve të vlerësimit të këtij program, planet për IPARD III”, vijon njoftimi.

“Programi IPARD II 2014 – 2020 ka filluar në vitin 2018. Ky program ka ofruar mundësi për prodhuesit dhe agropërpunuesit, që të përfitojnë drejtpërdrejt nga grantet, por edhe gjithë zonat rurale ku këto investime janë ngritur dhe janë të prekshme. Deri më tani janë nënshkruar 485 kontrata aktive në vlerë prej 83.6 milion euro kontribut publik, duke mbështetur: pika grumbullimi, fabrika përpunimi agrouchimorë, investime në mekanikë bujqësore dhe shtim siperfaqesh të mbjella, investime në subjekte agroturistikë, investime në stalla e ferma blegtorale, investime në kantina dhe vreshta, investime në serra, investime në energji të rinovueshme” thuhet në njoftim.



kontribut publik. Shifrat u bënë të ditura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përmes një njoftimi për mediet, ku u dhënë detaje mbi takimin e 11-të të Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD II 2014 – 2020, të zhvilluar në Tiranë. “Komitetit i Monitorimit monitoron efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD, duke shqyrtuar periodikisht progresin e

e bujqësisë dhe zhvillimit rural, si dhe autoritete publike. Në takim krahas anëtarëve të Komitetit të Monitorimit dhe strukturave të IPARD, ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Komisionit Evropian, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, si dhe organizata donatore”, njofton MBZHR. “Gjatë takimit të 11-të të Komitetit të Monitorimit u diskutuan çështje lidhur me

# Denaj pret ambasadorin e Zvicrës, diskutojnë mbështetjen për bujqësinë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj priti në një takim ambasadorin e Zvicrës në Shqipëri, Ruth Huber.

Denaj bëri të ditur se gjatë takimit u diskutua për mbështetjen që ky vend ofron për bujqësinë shqiptare.

“Nëpërmjet projekteve për forcimin e zinxhirit të vlerës dhe zhvillimin e kapaciteteve rregulatore synojmë të arrijmë standardet që kërkohen nga tregu i BE, duke na sjellë më afër me objektivin 1 miliard dollarë eksporte bujqësore deri në 2030”, u shpreh ministria Denaj.

Njëkohësisht Denaj tha se në takim u fol edhe mbi mundësinë e mbështetjes së arsimit të mesëm në shkollat profesionale

bujqësore, për të orientuar të rinjtë drejt kësaj fushe.

kanë mbështetur Shqipërinë me pothuajse 130 milionë franga



Bashkëpunimi midis Zvicrës dhe Shqipërisë filloi në fillim të viteve '90. SDC dhe SECO

zvicerane, duke kontribuar në zhvillimin social si dhe në zhvillimin e ekonomisë së tregut.

# Bujqësia, mes rritjes dhe sfidave - Flet për RTSH Ennio Civici: Ja rezultatet tona për vitin 2023

Bujqësia shqiptare vazhdon të tregojë shifra pozitive, pavarësisht sfidave të përvitshme që shkaktohen nga ndryshimet klimatike. Zëvendësministri i Bujqësisë Ennio Civici tregon, për RTSH, përpjekjet për përballimin e këtyre sfidave.

Politikat e reja dhe rritja e buxheteve në nivele historike për bujqësinë shqiptare ishin zgjidhja e vetme për Shqipërinë, për të përballuar presionin e jashtëzakonshëm si pasojë e prishjes së zinxhirit të tregjeve

“U detyruam vitin e kaluar të ndërtonim politika dhe të rrisim buxhete në nivele historike për të përballuar këtë presion në mënyrë që të mbanin nivelet e prodhimit në kushte të pranueshme normale”, u shpreh ai.

Në kushtet kur Shqipëria mbetet vendi më bujqësor në Europë, duke kontribuar në rreth 20% të prodhimit të brendshëm bruto, ministria gjeti një zgjidhje tjetër:

“Fuqizua për të disatën herë eksportet bujqësore shq-

iptare, por edhe me produktet e reja të cilat më parë nuk eksportoreshin. Shifrat e 9-mujorit vazhdojnë mbi 14 përqind rritje të eksportit dhe

ushqimorë dhe të kushteve me të cilat prodhohen. Po punojmë për të aplikuar më shumë teknologjinë, edhe panairi e kishte fokusin tek



Zëvendësministri i Bujqësisë Ennio Civici

ndërkohë prodhimi ka një ngadalësim të lehtë” deklaroi Civici.

Numri dy i ministrisë së Bujqësisë tregon edhe synimet e dikasterit deri në fund të këtij viti.

“Po punojmë për cilësinë, për të arritur atë më të lartën dhe jo vetëm në termat të çmimit më të lartë por edhe në atë të sigurisë

teknologjia. Po punojmë të forcojmë lidhjet me partnerët tanë ndërkombëtar” tha Zëvendësministri i Bujqësisë Ennio Civici.

Ndonëse çmimet e prodhimeve bujqësore janë rritur dhe kërkesa nga jashtë për prodhime shqiptare është e lartë, prodhimi nuk i është përgjigjur zhvillimeve të kohës.

# RisiAlbania mbështet webinarin mbi Turizmin e Qëndrueshëm

Shqipëria mund të rrisë potencialet e saj ekonomike duke shfrytëzuar më mirë zhvillimin e qëndrueshëm të Turizmit

Me përvojë në komunikim, marrëdhënie me publikun dhe gazetari për mbi 15 vjet, Eva

Kushova u fokusua në fushën e turizmit në vitin 2014, fillimisht me marketingun e tur-

izmit duke ndihmuar bizneset

(Vijon në faqen 10)

# KONFERENCË KOMBËTARE PËR ULLIRIN DHE CILËSINË E VAJIT TË ULLIRIT



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

## Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri Shtator 2023 - 2024



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Target Grupi

- ▶ Subjektet prodhuese të ullirit
- ▶ Subjektet përpunuese të vajit të ullirit
- ▶ Grumbulluesit për tregun e vendit
- ▶ Eksportuesit
- ▶ Konsumatorët e vajit të ullirit

#### Qëllimi

- ▶ Të krijohen më shumë kushte lehtësuese përmes dhënies së një asistence dobiprurëse në hallkat kryesore të zinxhirit të vlerës
- ▶ nxitja e të gjithë subjekteve të sipërcituara të vijojnë të punojnë për krijimin e një **Marke shqiptare të vajit të ullirit.**



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Hyrje

Draft programi është konceptuar të zbatohet sipas përvojës, modelit, praktikës dhe konkluzioneve të Programit “Mbështetje eksportit të vajit të ullirit përmes përmirësimit të cilësisë, shtator 2022-2023”.

#### Aktorët e përfshirë

- Shoqatat Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH),
- Kooperativa e Mikrofinancës (FED Invest shkk),
- Këshilli i Ekspertëve të Agrobiznesit (KEA),
- Shoqata Shqiptare e Vajit të Ullirit (AOA),
- Bashkimi Kombëtar i Fermerëve Shqiptarë (BKFSH),
- laboratoriu TENIUS, shoqëria ISOMETRIC SHPK,
- shoqatat italiane të importit të vajit të ullirit (COLDIRETTI),
- Qendra për Kërkime të Larta Agronomike (CIHEAM) në Bari Itali. Gjithashtu edhe subjektet publike:
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR),
- Ministria Italiane e Bujqësisë, Kooperacionit Italian në Shqipëri.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë (ASH)
- Agjensitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB),
- Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB),
- Projekti RISI Albania, një projekt inovativ, i financuar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në partneritet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE).



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Procesi i përmirësimit të kooperimit dhe koordinimit

- ▶ Takim për vijimin e veprimtarisë i grupit aktual kombëtar të punës, ekspertëve të KEA
- ▶ Përgatitjen e një Draft-programi dhe Memorandumit Bashkëpunimi të KASH me MBZHR si dhe me aktorët e tjerë të përfshirë
- ▶ Propozim dhe lobim nga KASH për ngritjen dhe funksionimin pranë MBZHR të një Komiteti Kombëtar për “Ullirin dhe cilësinë e vajit të ullirit në Shqipëri”
- ▶ Përgatitja e termave të referencës për veprimtarinë e subjekteve pjesëmarrës në zbatimin e programit, të p/buxhetit të shpenzimeve, nënshkrimi i marrëveshjeve dhe kontratave me subjektet dhe ekspertët që do të angazhohen në zbatimin e programit
- ▶ Organizimi një konference kombëtare me temë “Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri”
- ▶ Asistencë për krijimin dhe funksionimin e Shoqërive të Bashkëpunimit dhe klasterave për ullirin dhe vajin e ullirit



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Zgjerimi i aktorëve të përfshirë



Instituti i Bujqësisë Biologjike Durrës (IBB)	Grupin teknik të punës për Certifikimin Global Gap,	Instituti, e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV),
Agjensinë Kombëtare të Ushqimit (AKU),	Agjensinë e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB),	Agjensinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural AZHBR
Organet e qeverisjes vendore Bashki, Qark, Prefekturë.	Programin për Cilësinë dhe Standardet Globale (GOSP), programi financiar nga Agjensia e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO),	Projektin e Qendrës Tregtare Ndërkombëtare (ITC), financiar nga qeveria zvicerane, përmes Sekretariatit shtetëror për ekonominë dhe tregtinë (SECO)
	Projektin Mbështetjeje e Bashkimit Europian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri (EU4SI).	



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Fusha e Mekanizimit, Inovacionit dhe Digjitalizimit

- ▶ Asistencë për përmirësimin e kontrollit të cilësisë dhe përdorimin e teknologjisë bashkëkohore të subjekteve të prodhimit të fidanave të ullirit
- ▶ Asistencë Shoqërive të Bashkëpunimit, me objekt shërbimet ndaj bimës së ullirit, pajisjen me inventarin e makinerive të duhura, për vjeljen e mekanizuar, transportin dhe përpunimin e ullirit, ruajtjen dhe ambalazhimin e vajit në kushte optimale
- ▶ Krijimi i hartës digjitale të vendndodhjes së linjave të përpunimit të ullirit për vaj, si dhe hartimi e përdorimi i një programi digjital komunikimi midis subjekteve të angazhuara në program përmes platformës elektronike ABA Online dhe Portalit të fermerit
- ▶ Asistencë linjave të përpunimit të vajit për hartimin e Plan-biznesit, projektet e vendosjes së depozitave të vajit, mënyrën e përdorimit të laboratorëve digjitalë portativë, për kryerjen e analizave të shpejta, për klasifikimin e vajit sipas cilësisë
- ▶ Asistencë për krijimin dhe funksionimin e Qendrave të Menaxhimit të Cilësisë së ullirit dhe vajit të ullirit
- ▶ Asistencë grumbulluesve dhe eksportuesve të vajit për përgatitjen dhe promovimin e një oferte për sezonin 2023 – 2024 sipas kërkesave të tregut të vendit dhe atij për eksport



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Qëllimi i programit

Dhënie e asistencës për:

Procesin e kooperimit dhe koordinimit

Fushën e mekanizimit, inovacionit dhe digjitalizimit

Fushën e financimit dhe disbursimit të fondeve grant

Fushën e përmirësimit të akteve ligjore dhe nënligjore



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Fusha e Financës dhe disbursimit të fondeve grant

- ▶ Asistencë dhe informim për financim nga Programi IPARD III, Skema Kombëtare e Mbështetjes me grante përmes buxhetit të shtetit, Bankat e nivelit të dytë, FED Invest shkk, dhe donatorët, për të mundësuar një linjë kredie me kushte lehtësuese
- ▶ Ndërgjegjësim, promovim, mbështetje logjistike dhe financiare të subjekteve të angazhuara në program nga donatorët, që e kanë si objekt vajin e ullirit dhe pranojnë të angazhohen në zbatimin e programit.
- ▶ Lobim për subvencionim nga AZHBR të interesave të kredisë së marrë nga grumbulluesit dhe eksportuesit të tepricave të vajit të ullirit nga fermerët
- ▶ Përdorimin e garancisë sovraane si kolateral për kredite e marra për investime dhe mjete xhiroje nga subjektet për grumbullimin dhe ruajtjen në kushte të përshtatshme të vajit të ullirit.
- ▶ Përgatitja e P/buxhetit për zbatimin e Programit “Ulliri dhe cilësia e vajit të ullirit në Shqipëri shtator 2023-2024”
- ▶ Mbështetje financiare për përgatitjen dhe botimin e Gazetës “Agrobiznesi”, si dhe në medianë e shkruar dhe atë audiovizive
- ▶ Informim e ndërgjegjësim e fermerëve dhe subjekteve të tjerë, përmes hapjes së rubrikave të reja të dedikuara ullirit dhe cilësisë së vajit të ullirit, realizimit të videove promovuese dhe sensibilizuese, për dobimin e vijimit të zbatimit të Programit, për Ullirin dhe Cilësinë e vajit të ullirit në Shqipëri
- ▶ Mbështetje financiare dhe logjistike për të paguar shpenzimet për ekspertët e angazhuar me kohë të pjesshme në program. Si dhe blerjen e pajisjeve laboratorike, për kryerje analizash në terren të domosdoshëm në zbatimin e programit.
- ▶ Përgatitjen e plan-bizneseve për të mundësuar financim me kushte lehtësuese si dhe projekteve teknike, për subjektet që janë angazhuar në zbatimin e programit
- ▶ Mbështetje financiare dhe logjistike për krijimin dhe kualifikimin e personelit të Qendrave të Menaxhimit të Cilësisë, të Grupit të panel testit të degustimit të vajit të ullirit. Si dhe ekspertëve të subjekteve, për kryerjen e analizave të thelluara në laboratorët e certifikuar.



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Synimet e programit

Të koordinojë veprimtarinë praktike të 24 subjekteve të sipërcituara

Të përshpejtojë zgjidhjen e problemeve emergjente afatshkurtra

Të vendosë në rrugën e zgjidhjes së qëndrueshme problemet afatmesme dhe afatgjata

Të asistojë çdo hallkë të zinxhirit të vlerës

Të shtojë numrin e subjekteve të asistuar deri tani nga programi, duke filluar nga prodhimi i fidanave të ullirit dhe përfunduar tek konsumatori final i vajit të ullirit



KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

### Fusha e përmirësimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

Lobim për fillimin e punës për hartimin e një ligji dhe disa akteve nënligjore për ullirin dhe vajin e ullirit në Shqipëri

Informim mbi Legjislacionin dhe aktet nënligjore të vendit dhe BE që janë në fuqi dhe impaktojnë ullirin dhe vajin e ullirit.



## Konferenca e vajit të ullirit, Denaj: Nxitje prodhimit me standarde

ullirit drejt Italisë.

“Rrugëtim e nisa me një

angazhimit të tij, në 8 muajt e parë të këtij viti eksporti i vajit



angazhim me ministrin italian, Francesco Lollobrigida. Falë

të ullirit drejt Italisë shkoi në 5220 tonë, nga 62 litra që ishte

në 2022. Ministri Lollobrigida më siguroi se tregu italian është i gatshëm të pranojë më tepër sasi të vajit të ullirit shqiptar”, theksoi ministrja.

Ministrja foli dhe për nevojën e përbushjes së standardeve që kërkon sot tregu për tregtimin e vajit të ullirit.

“Objektivi është që në dy-tre vitet e ardhshme nuk duhet të ketë më bidonë vaji. Ky është një objektivi që na angazhon në të gjithëve që bidonin ta zëvendësojmë me një ambalazh, i cili e ruan cilësinë e vajit. Kjo cilësi prevalon pastaj në treg dhe mbi të gjitha, e shet me vlerë. Kjo është pasuria jonë kombëtare. Ne duhet t’i punojmë të gjitha këto rrënjë

ulliri, t’i konsiderojmë si pasuri kombëtare që nuk mund të pritet, por duhet të punohet me përkushtim”, u shpreh Denaj.

Duke u ndalur në automatizimin e sektorit, si një nga sfidat e bujqësisë sot, ministrja ftoi fermerët që në çdo zonë, ku është mundësia të kultivojnë më shumë këtë produkt.

Ajo inkurajoi bujqit të rrisin kultivimin e ullirit dhe të mendojnë se si ta rrisin vlerën e tij në treg.

“Me këtë objektivi, të punojmë së bashku që të mundësojmë bashkimin, investimet dhe të hyjmë në tregje të tjera”, tha ministrja.

Denaj solli në vëmendje se, rendimenti ekonomik është ai që motivon secilin biznes,

pastaj motivon bankat për të shkuar tek to.

“Jam shumë e lumtur që kisha një stendë të Albsigut, gjë që motivon dhe kompanitë e sigurimit për të dhënë oferta për sigurimin me prime të aksesueshme. Sfida është të bëjmë bashkimin e të gjithë aktorëve jo në mënyrë të sforcuar, por një bashkim organik interesi ku produktet të kenë vlerën dhe cilësinë, sipas standardeve më të mira, për të bërë që tregjet ndërkombëtare të përthithin produktet tona”, tha Denaj.

Denaj dëgjoi nga panelistët profesorë dhe akademikë, mendimin e tyre mbi piketat e punës në atë se çfarë duhet të bëjë secili nga aktorët e sektorit, teksa falenderoi të gjithë donatorët, ndër të cilët Risi Albania për mbështetjen e dhënë në këtë sektor dhe për modelin më të mirë që ata kanë sjellë në dobi të zhvillimit.

Shqipëria mund të kthehet në një vend konkurrues sa i takon prodhimit dhe eksportit të vajit të ullirit në tregjet ndërkombëtare por për këtë i duhet të konsolidojë markën e saj. Vetëm këtë 8-mujor eksportet kapën vlerën e 25 milionë eurove, me rritje vjetore gati 7 herë më të lartë në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Me një traditë të gjatë në kultivimin e ullirit dhe prodhimit të vajit, vëmendja e re që ka marrë sektori dhe investimet, po e bëjnë gjithmonë e më të prekshëm zgjerimin në tregje të reja.

Pikërisht kjo ishte epiqendra e një konference të dedikuar mbi këtë çështje në Expo City, nën titullin “Ulliri dhe Cilësia e Vajit të Ullirit në Shqipëri”, ku diskutua mbi arritjet e eksportit në vitet e fundit, sfidat dhe zgjidhjet e tyre, si dhe objektivat që aktorët kryesorë kanë për këtë produkt.

Ekonomisti agrar, Drini Imami u shpreh se edhe pse prodhimi i vajit të ullirit përjetoi një ecuri shumë të mirë vitin e shkuar, mbiprodhimi u kthye në një sfidë për t’u menaxhuar pasi zgjidhja kryesore për këtë situatë është eksporti. Pikërisht në këtë drejtim sugjeroi ai që të jetë fokusi kryesor kur flasim për këtë kulturë.

“Rritja e prodhimit të vajit ka nxitur konsumin në popull-

si, por gjatë kësaj periudhe kemi vënë re shumë sfida. Edhe pse vitin e kaluar kemi pasur mbiprodhim, sivjet kemi rendiment të ulët. Problematika më e madhe që unë shoh se do të përballemi për shumë kohë është mbiprodhimi i cili kërkon eksport. Pikërisht në këtë çështje duhet të fokusohemi- u shpreh Imami

Stephan Joss drejtues i projektit të Risi Albania u shpreh se ndryshimet klimatike në Itali edhe Spanjë kanë ndihmuar në eksportet e vajit nga Shqipëria por duhen zgjidhje afatgjate që të vendi ynë të vendoset në hartë. Duhet krijimi i një marke dhe rritja e cilësisë që produktet shqiptare të konkurrojnë denjësisht me vende si Italia, Greqia dhe Spanja.

“Dua të nis me ndryshimet klimatike. Kur ministria na kontaktoi për këtë çështje, Spanja dhe Italia në atë kohë po vuanin nga një thatësi që kishte dëmtuar prodhimin e tyre të ullirit. Kur ministrja na kontaktoi, kërkoi që ne të gjejmë një zgjidhje afatgjate dhe jo vetëm për një vit, pasi Shqipëria fatmirësisht nuk u përball me fatkeqësi të tilla

Ne si eksportues duhet të përgatitemi për situata të paparashikueshme, si për tregun vendas ashtu edhe për atë



të huaj. Ne duhet të shohim potencialin e vërtet të këtij produkti. Duhet të brendojmë dhe të vendosim një imazh të vajit të ullirit për të theksuar vlerën e vërtetë. Por duhet të rritet besimi te konsumatorët, dhe kjo bëhet vetëm duke menaxhuar cilësinë. Është e vërtetë që duhet të investohet në pajisje, por fitimet e marra pas rritjes së cilësisë do të jenë gjithmonë e më të shumta. Bashkimi i të gjitha këtyre na

vendos në hartë me shtetet e tjera, duke na bërë të barabartë dhe duke konkurruar denjësisht me Spanjën, Italinë dhe



Greqinë.” - u shpreh Joss

Ministrja e Bujqësisë Anila Denaj bëri thirrje për bashkëpunim të të gjithë aktorëve kryesor të tregut në mënyrë që të krijohet një ekonomi shkalle që të arrihet rendimenti ekonomik i duhur. Denaj vuri theksin edhe te tregtimin i vajit nën etiketë dhe jo në format që e shohim sot, pasi ky tregtim ul vlerën e produktit jo vetëm në tregun kombëtar por edhe në atë ndërkombëtar.

“Statistikat na japin informacion për të krijuar politika. Ne shohim që sasia e eksportit ka rritur nga 149 tonë në mbi 300 tonë. Janë disa gjëra që duhet të orientohen. Ne duhet të krijojmë një ekonomi shkalle që të arrijmë nivelin e duhur të rendimentit ekonomik aty ku duhet. Duhet të bashkëpunojmë me të gjithë aktorët, ku produktet të kenë vlerën e duhur sipas tregut. Nuk duhet të ketë më bidonë plastik, vaji duhet të zëvendësohet me etiketë që të kemi një vlerë fikse.

Nëse ne shesim lirë produktin tonë, ne nënvlerësojmë pasurinë që na është dhënë. Për çdo zonë që ka mundësi të kultivojë vajin, duhet të rrisë sa më shumë rendimentin dhe jo të mendojë të ulë çmimin.”

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit, Agim Rrapaj shprehet që sukcesi i arritur nuk do ishte i mundur pa bashkëpunimin e 14 objekteve që në fokus kishin rritjen e vlerës së vajit në tregjet e huaja dhe përmirësimin e cilësisë

Kemi pasur një vit shumë të suksesshëm këtë vit, dhe ky sukses i përket më së shumti bashkimit të 14 subjekteve që

kanë pasur kulturën e ullirit si fokusin kryesor. Ishte pikërisht ky bashkimi që bëri të mundur arritjen e këtyre rezultateve.

Në periudhën 2021-2022 ne kemi eksportuar rreth 149 tonë vajë sot jemi në shifra e 7 mijë tonë vaj që nuk janë të regjistruar fikse. Kjo kulturë ka një potencial të madh që ne jemi përpjekur që ta arrijmë gjithmonë e më shumë janë bërë analizat e duhura për të provuar cilësinë e produktit.

Megjithatë, gjatë vitit kemi hasur në sfida të ndryshme dhe për të përshkruar nivele më të larta të suksesit, të cilat janë të mundshme kemi bërë thirrje edhe për bashkimin e 10 subjekteve të tjera vitin e ardhshëm, për të ndihmuar në çdo fazë të zinxhirit të prodhimit. Kjo do të na ndihmojë të zgjidhim problemet afatmesme dhe afatgjate.

Rrapaj u shpreh që objektivi kryesor është krijimi i një marke shqiptare që përfaqëson produktin sa më mirë në tregjet e huaja

“Objektivi kryesor është krijimi i një marke shqiptare që të përfaqësojë produktin vendas sa më mirë në tregjet ndërkombëtare. Për të arritur këtë, duhet të hartojmë një plan të gjerë për përmirësimin e cilësisë së vajit të ullirit” tha ai.

## Forumi për Cilësinë dhe Standardet në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike: Një Hap Drejt Zhvillimit të Industrisë Shqiptare

Në datën 25 tetor 2023, Shkodra u bë qendra e një ngjarje të rëndësishme në botën e bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në Shqipëri. Forumi "Institucionet e Infrastrukturës së Cilësisë në Shqipëri dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për Cilësinë dhe Standardet në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike" u organizua në ambientet e "Shporta e Recit", Malësia e Madhe.

Ky forum u organizuar në kuadër të projektit Global and Quality Standard Program (GQSP), një projekt i financuar nga Qeveria e Zvicrës në kuadër të Sekretariatit të saj Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO dhe zbatuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO). Qëllimi i këtij program është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të standardeve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) nësektorin e BAM. Kjo synonte rritjen e eksporteve dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve të of-

ruara nga ky sektor.

Qëllimi kryesor i forumit ishte ndarja e rezultateve paraprake të njësimit të gjerë që ishte kryer në sektorin e BMA dhe laboratorëve të cilësisë në Shqipëri. Ky vlerësim paraqitisituatën aktuale të bizneseve vendase në këtë sektor, duke identifikuar nevojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ato. Gjithashtu, në fokus ishte edhe analiza e

laboratorëve në vend, sfidat dhe mundësitë në respektimin e standardeve të cilësisë. Duke iu kushtuar kësaj analize thelbësore, u referuan disa çështje kyçe që kanë të bëjnë me praktikën laboratorike dhe cilësinë e punës në këto ambiente.

Në diskutimet e forumit u theksua roli i akreditimit në zinxhirin e vlerës së bujqësisë. U diskutua se si standardizimi mund të përmirësojë koordinimin mes palëve të interesuara, duke filluar nga ferma deri te tregu. Po ashtu, u bë e qartë rëndësia e përbushjes së standardeve të cilësisë dhe sigurisë për të siguruar qasje në tregjet vendore dhe ndërkombëtare. Diskutimet theksuan edhe rolin e proceseve të testimit, inspektimit dhe certifikimit në ruajtjen e standardeve të cilësisë, duke vënë

në pah nevojën për kornizat ligjore kombëtare dhe agjencitë përgjegjëse për zbatimin e standardeve të cilësisë në sektorin e bujqësisë.

Ky forum nuk ishte vetëm një takim, por një hap konkret drejt ndryshimeve të rëndësishme në industrinë e bimëve mjekësore dhe aromatike në Shqipëri. Duke krijuar një rrjet të standardeve dhe duke ndarë njohuri dhe praktika të mira, sektori i BMA është në rrugën e duhur drejt rritjes së cilësisë dhe konkurrueshmërisë në tregun ndërkombëtar. Ky forum u bë një shembull frymëzues për bashkëpunimin dhe inovacionin në fushën e bimëve mjekësore dhe aromatike në vendin tonë.





SIPËRMARRJE NË BUJQËSI

# Vështirësitë e bletarisë! La emigrimin për vendlindjen, 28-vjeçari prodhon mjaltë në Dukat

150 bletërritësve të zonës së fshatit Dukat të Vlorës iu shtua dhe një 28 vjeçar, i cili la emigrimin në Itali për të punuar pranë familjarëve të tij. “Nuk mund të jetoja në Itali pasi jetesa atje ishte shumë e vështirë. Emigrimi është shumë i vështirë, pasi mungojnë miqtë, familjarët mungojnë shumë gjëra. Ndërsa këtu je afër me familjen dhe punën së bashku me ta”, shprehet bletërritësi, Edison Qesargjoni. Qesargjoni ndodhet në zonën poshtë malit të Karaburunit, aty ku kujdesej për kosheret e bletëve me tymuesen në dorë. “Unë këtu primare kam bletarinë që e kam trashëguar nga babai dhe shkoj çdo ditë në zonën ku ndodhen kosheret, po ashtu dhe punë të tjera që ka familja me bujqësinë. Kemi

rreth 240 koshere me bletë si familje, në Karaburun dhe në zonën e fshatit të Dhërmiut, por po ashtu mungesa e subveco-neve”, thotë ai. Edison ka nisur dhe uni-



EDISON QESARGJONI - BLETËRRITËS

kemi dhe probleme”, shprehet 28-vjeçari, “mungesën e tregut të shitjes së mjaltit apo dhe prodhimeve të tjera bujqësore, versitetin. Ai u bën thirrje dhe bashkëmohatarëve të tij që nëse u jepet mundësia të kthehen në vendlindje.

# Elvana Zhezha nga Korça; “Koha për të rritur standardet e bimëve medicinale, tregu kërkon cilësi”

Për të dalë në tregun rajonal dhe më gjerë me bimët medicinale dhe ato aromatike fermerët e juglindjes së vendit duhet të bëjnë kujdes në trajtimin e tyre, edhe për të ruajtur sa më shumë të jetë e mundur standardet e një tregu me shume se lokal. Për doktoreshen e shkencave bujqësore Elvana Zhezha fermerët duhet të kenë parasysh kultivimin e këtyre bimëve pa përdorur plehra kimike dhe pesticide, nëse do të duan të jenë konkurrues në treg me prodhime të një cilësie të lartë.

Qarku i Korçës nga viti në vit ka shtuar sipërfaqet e mbjella me bimë medicinale dhe aromatike. Një pjesë e fermerëve që merren me kultivimin e këtyre bimëve, edhe për shkak

të rritjes së sipërfaqeve kanë aritur të kenë partneritet në tre- Ka fermerë të tjerë me sipërfaqe më të vogla që për shkak



gun European dhe me gjere. E gjithë kjo ka ardhur për shkak të ruajtjes së standardeve të kultivimit të këtyre bimëve. të mosruajtjes së standardeve e kanë patur të vështirë të gjejnë treg, e kur e kanë gjetur, e kanë gjetur me çmime të ulëta.

Zëvendëskryeministrja, njëherësh ministre e Infrastrukturs dhe Energjisë, Belinda Balluku, së bashku me ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, inspektuan shkollën e mesme bujqësore në Cërrik, ku së shpejti do të nisë edhe rikonstrukcioni i konvikteve, për të kthyer këtë shkollë në një qendër rajonale.

Zëvendëskryeministrja Balluku theksoi se do të ketë një fokus të përqendruar tek arsimit profesional, pasi në treg është gjithmonë shumë vështirë të gjenden profesionistë të tillë dhe padyshim një rëndësi e veçantë do t'i jepet bujqësisë.

“Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të ketë një fokus të përqendruar tek arsimit profesional dhe sigurisht të gjitha shkollat profesionale janë të

rëndësishme, ato që prodhojnë hidraulikët, elektricitet, sepse qendër rajonale, ministria do të bëjë të gjitha alokimet e duhura të fondeve për t’u siguruar edhe bazën materiale për studim.

“Këtij investimi në infrastrukturën akomoduese për të shtuar kapacitetet e studentëve do t’i shtojmë edhe bazën materiale. Në buxhetin e vitit që vjen do të sigurojmë fondet, në mënyrë që të ofrojmë të gjithë bazën materiale edhe për numrin e shtuar të nxënësve”, tha Denaj.



# Shqipëria nis pyllëzimet me dron - Risia e Universitetit Bujqësor, Toromani: Ul ndjeshëm kostot e mbjelljes së pemëve

Universiteti Bujqësor i Tiranës do të testojë mbjelljen e kjo teknikë e re, që shfrytëzon avancimin e teknologjisë,



ELVIN TOROMANI  
PROFESOR, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

pemëve me dron. Prof. Elvin Toromani thotë për TV SCAN aplikohet për herë të parë në vendin tonë.

Sipas profesorit, kjo metodë ul ndjeshëm kostot e pyllëzimit, që shpesh herë kanë qenë problem në drejtim të shtimit të sipërfaqeve pyjore në vend. Fillimisht mbjella e pemëve përmes hedhjes së farave nga droni do të testohet në 3 zona e më konkretisht në terrenet që ka në administrim Universiteti Bujqësor i Tiranës, në Korçë dhe në Pishë Porro që u përfshi nga zjarret së fundmi. Ndërkohë që, nëse rezultoni me sukses Toromani rekomandon që ajo të përdoret nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në të ardhmen. Rezultatet e para të këtij procesi do të dalin në periudhën shkurt – mars të vitit që vjen.

# Denaj bisedë me studentët të Universitetit të Tiranës mbi efektet e ndryshimeve klimatike

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një takim me studentët të Universitetit të Tiranës, me të cilët bisedoi mbi efektet e

“Diskutuam veçanërisht mbi sigurinë ushqimore bashkë me partnerët tanë strategjik, ambasadën spanjolle për rrugëtimin drejt integritimit në

madh për mjedisin në historinë e tij në dhjetor të vitit 2020. 27 vendet anëtare ranë dakord në Bruksel për një reduktim madhor të emetimeve të gazit CO2 në 10 vjet, bazuar në planin për rimëkëmbjen ekonomike të shteteve anëtare pas krizës së COVID.

Sipas planeve për të cilat u ra dakord pas një negociimi maratonë të ndërmjetësuar nga presidenca gjermane, blloku angazhohet të shkurtojë me 55% emetimet e CO2-shit brenda vitit 2030.

Marrëveshja e Gjellbër e BE-së dhe promovimi i ndryshimit të politikave dhe investimeve në konsum dhe prodhim të qëndrueshëm janë prioritet për BE-në dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.

Shqipëria u angazhua për një objektiv të reduktimit të pakushtëzuar të emetimeve prej 20.9% deri në vitin 2030.



ndryshimeve klimatike.

Në takim ishin të pranishëm dhe ambasadori i Spanjës në Shqipëri, Álvaro Renedo Zalba, si dhe përfaqësuesja e UNDP-së në vendin tonë, Monica Merino.

BE dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara United Nations Albania drejt përmirësimit të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG)”, deklaroi ministria Denaj.

BE i dha jetë planit më të

# Balluku dhe Denaj: Shkolla e mesme bujqësore në Cërrik do të kthehet në një qendër rajonale

rëndësishme, ato që prodhojnë hidraulikët, elektricitet, sepse qendër rajonale, ministria do të bëjë të gjitha alokimet e duhura të fondeve për t’u siguruar edhe bazën materiale për studim.

“Këtij investimi në infrastrukturën akomoduese për të shtuar kapacitetet e studentëve do t’i shtojmë edhe bazën materiale. Në buxhetin e vitit që vjen do të sigurojmë fondet, në mënyrë që të ofrojmë të gjithë bazën materiale edhe për numrin e shtuar të nxënësve”, tha Denaj.



në këtë zonë jep rendiment ekonomik, ndaj dhe lëvizja demografike në këtë zonë është e ulët”, u shpreh Denaj.

Sipas saj, biznesi do t’i punësojë në mënyrë të menjëhershme dhe do t’i paguajë mirë.

Nga ana tjetër zv/ministria e Financave dhe Ekonomisë, Olta Manjani bëri të ditur se asnjëherë nuk është i vështirë punësimi për të rinjtë që përfundojnë studimet në arsimin e mesëm profesional.

Të dhënat e fundit, tha ajo, tregojnë se 60% e studentëve që përfundojnë studimet gjatë punës brenda 6-mujorit të parë.

Konvikti i ri që do të ndërtohet parashikohet të akomodojë deri në 200 studentë dhe pritet të jetë gati në fillim të vitit të ardhshëm shkollor.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË  
FINANCË SOCIALE**

## Jaço përfundon mandatin si President i AmCham-it: Shqipëria potencial për të 5-fishuar investimet amerikane

Në përfundim të mandatit të tij si president i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço bëri thirrje për progres të prekshëm në përmirësimin e klimës së investimeve.

Jaço foli gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të AmCham në praninë e 256 kompanive anëtare, ku deklaroi se duhet ende shumë punë që Shqipëria të bëhet “magneti i Ballkanit” për investitorët e huaj.

Ai u bëri thirrje bizneseve anëtare të përfshihen sa më shumë që zëri i tyre të dëgjohet.

“Rruga jonë nuk është pa sfida. Dikush një herë tha që nëse keni rritje 250% të investimeve, çfarë doni më shumë? Përgjigjia ime është ne nuk duam thjesht më shumë. Ne duam shumë më shumë. Ne vlerësojmë se potenciali i Shqipërisë është për të 5-fishuar investimet amerikane, për t'i bërë ato nga 220 milionë në dollarë mbi 1 miliard dollarë. Kjo do e krahasonte Shqipërinë me ato vendet që thithin më shumë investime në Ballkan”, u shpreh Jaço.

Por për të arritur këtë, vijoi ai, duhet një klimë biznesi

që mundëson konkurrencën e ndershme dhe lufton të pandershmen, me paketa ligjore që parandalojnë korrupsionin.

“Gjithashtu kërkojmë reformimin e prokurimeve publike në platforma reale dhe trans-



parente ku investitorët e huaj të konkurrojnë lirshëm krahas bizneseve lokale, përcaktimin e incentivave dhe standartzimitin e kriterëve automatike për marrjen e lejeve të investimeve në mënyrë që Shqipëria të merret seriozisht nga investitorët e huaj”, bëri të ditur ai.

Jaço u shpreh se reforma

mund të arrihet vetëm me një bashkëpunim real mes sektorit privat dhe administratës publike.

“Pavarësisht këtyre sfidave, ose ndoshta për shkak të tyre, tani më shumë se kurrë është e rëndësishme që të sigurojmë të

ardhmen e tregtisë, bizneseve, hapjen drejt investimeve të reja dhe hapjen drejt investimeve të vërteta strategjike ku Dhoma Amerikane ka një rol të rëndësishëm për të luajtur” u shpreh Jaço.

Enio Jaço drejtoi Dhomën Amerikane të Tregtisë për dy mandate.

## Rritja e çmimeve - Tregtarët e pakicës thonë se përcaktohen nga shumica

Prodhimet e vendit nuk janë të mjaftueshme për tregun shqiptar ndërkohë që çmimet e frutave dhe zarzavateve janë rritur.

Tregtarët e pakicës shprehen se çmimi përfundimtar nuk rritet prej tyre por prej shumicës dhe për ta ka rënë fuqia blerëse.

“Çmimet vazhdojnë rritjen edhe nga shumica dhe vazhdojnë rritjen se edhe prodhimi është i pakët. Patjetër që ka rënë dhe blerja”, shprehet tregtari.

Qytetarët nga ana tjetër, theksojnë se çmimet vijnë të rriten dhe kanë vështirësi t'i përballojnë sidomos pensionistët që tregojnë se pa ndihmë, sidomos të fëmijëve nuk ia dalin dot.

“Jam pensioniste dhe më shumë vështirësi. Jam vetëm pa

fëmijë dhe jemi të detyruar të hamë më pak, se duhen blerë edhe ilaçet”, shprehen pensionistët.

pije joalkoolike” me 2.80 pikë përqindje, krahasuar me gushtin e 2023, ndërsa nëse krahasohen




Sipas Institutit të Statistikave, në shtator rritjen më të madhe të çmimeve e ka pësuar pikërisht gupi “Ushqime dhe

muajt me njeri-tjetrin në shtator, çmimet e ushqimeve janë rritur me 7.9% krahasuar me shtatorin e një viti më parë.

## RisiAlbania mbështet webinarin mbi Turizmin e Qëndrueshëm

(Vijon nga faqja 2)

turistike të promovonin produktet e tyre në tregjet në mbarë botën dhe më vonë duke u fokusuar në marketingun e destinacioneve. E trajnuar dhe certifikuar në fushën e Turizmit të qëndrueshëm nga GSTC, Kushova iu bash-



Eva Kushova  
Eksperte e Turizmit

kua webinarin mbi Turizmin e Qëndrueshëm.

Kjo seri webinarësh, organizohet për herë të parë në gjuhën shqipe, në bashkëpunim me HSLU Hochschule Luzern, përgjatë muajve Tetor-Dhjetor 2023, vjen pas shumë interesimeve dhe regjistrimeve, nga aktorët e linjës dhe subjektet e ndryshme.

Këtë të enjte, datë 26 tetor, ekspertja Eva Kushova foli për bazat e turizmit të qëndrueshëm, nën lajmotivin “Së bashku, mund të ndërtojmë një të ardhme më të qëndrueshme dhe të pasur për turizmin në Shqipëri”.

Programi i seksionit të parë të këtij webinar-i ishte: Turizmi i qëndrueshëm, bazat dhe konceptet. Seksioni i 2-të u fokusua tek: Standardet e turizmit të qëndrueshëm dhe kriteret (angazhim i pjesëmarrjeve, pyetësor) dhe Seksioni 3-të: Shqipëria - raste

studimi.

Objektivat e këtij webinarit ishin: Ofrimi i një shpjegimi të parimeve themelore të turizmit të qëndrueshëm. Pse duhet, pse ka rëndësi? Prezantimi i kriterëve botërore të turizmit të Qëndrueshëm dhe si t'i lexojmë dhe kuptojmë ato dhe prezantimi i praktikave më të mira në këtë fushë.

Nuk është një formë e re e turizmit, por është e ardhmja e turizmit. Herët a vonë, të gjitha llojet e turizmit do të jenë të qëndrueshme. Përkufizimi UNWTO (Organizata Botërore e Turizmit) “Turizëm që merr parasysh plotësisht ndikimet aktuale dhe të ardhshme ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke adresuar nevojat e vizitorëve, të industrisë së turizmit, mjedisit dhe komuniteteve pritëse.” Përkufizim më i thjeshtë: Turizmi që minimizon ndikimin në mjedis dhe maksimizon përfitimet për komunitetet.

Kushova tha se, 4 janë shtyllat e Turizmit të Qëndrueshëm: Menaxhim i Qëndrueshëm; Qëndrueshmëria ekonomiko sociale; Qëndrueshmëria Kulturore; Qëndrueshmëria mjedisore.

Ajo shpjegoi se pse turizmi duhet të bëhet i qëndrueshëm

Së pari vijoi Kushova, është detyrim për gjithë vendet e OKB. Mbi bazën e një marrëveshjeje midis liderëve në OKB në 2015. Programi universal 2030 u parashtroi vendeve të ndjekin 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Qellimi është: t'i japë fund varfërisë ekstreme, të luftojë pabarazinë, padrejtësinë dhe të përballojë ndryshimet klimatike deri në 2030.

Turizmi luan rol kyç në ar-

ritjen e këtyre objektivave; People, Planet, Prosperity-Njerëzit, planeti dhe prosperiteti;

Redukton varfërinë (People); Turizmi është forca lëvizëse ekonomisë botërore. Sipas statistikave zyrtare 700 mln turistë numërohen për periudhën janar-korrik 2023, 43% më shumë se 2022. 1 në 10 persona punon në turizëm, direkt ose indirekt. Në disa vende, turizmi përbën 20% të PBB-së

Mbron Planetin (Planet), Turizmi masiv shkatërroi burimet mjedisore e kulturore; - Industria e turizmit, ndotësi i 4-t në Europë; Turizmi shkakton 8% të emetimeve globale të gazeve serrë; Rrit përfitimet për industrinë turistike (hotelet) Booking.com 2023

### Raport i Turizmit të Qëndrueshëm

• 76% e udhëtarëve shprehin dëshirën për të udhëtuar në mënyrë më të qëndrueshme në 12 muajt në vijim

• 43% e udhëtarëve do paguanin më shumë për një hotel/subjekt që ka certifikatë qëndrueshmërie

• 65% do ndiheshin më mirë nëse e dinë që ai hotel ka certifikatë qëndrueshmërie

• Mbi 500,000 akomodime globalisht po promovohen me një etiketë në Booking.com (gjethe jeshile

### Turisti i informuar

• 67% e fikin ajrin e kondicionuar kur nuk përdoret • 60% ripërdorin peshqirët për arsye të ngjashme 33 mijë të pyetur nga 35 vende.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

## Skema Kombëtare, AZHBR financon 307 ferma organike me fond 46,4 milionë lekë

Bujqësia organike në Shqipëri po zhvillohet gjithmonë e më tepër, duke sjellë jo vetëm produkte cilësore në treg, por edhe fitime më të larta për fermerët.

Fermat me prodhim organik kanë dyert e hapura drejt eksportit, duke mundësuar rritjen e konkurrueshmërisë dhe modernizimin e sektorit.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) përmes Skemës Kombëtare 2023 vazhdon të mbështesë fermat organike, ku prej vitit 2017 e deri më tani, janë financuar 307 ferma me një fond

prej 46,4 milionë lekësh.

Ndërkohë AZHBR ka në proces financimi edhe 27 ferma të reja organike.

Sipas kriterëve që ka miratuar qeveria për subvencionet në bujqësinë organike bizneset e kësaj linje përfitojnë mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës.

Fermat organike, për vitin e parë, përfitojnë financim në vlerën 100 000 lekë, në vitin e dytë, 150 000 lekë dhe 200 000 lekë për fermat të certifikuar.

Ministria e Bujqësisë duke vlerësuar fizibilitetin e investimeve në bujqësi, përzgjodhi agroturizmin si modelin më të suksesshëm teksa vlerësoi se fermat bujqësore organike janë një vlerë e shtuar dhe fitimprurëse për zhvillimin rural në tërësi.

Sotfermerët dhe bizneset e agroturizmit po rrisin interesin për të investuar në ferma organike dhe rritjen e prodhimit bujqësor bio, që është mjaft i kërkuar krahas eksportit edhe nga vizitorët, turistët vendas dhe të huaj.

## Drejt përfundimit vjelja e qepës, prodhim cilësor i kësaj kulture në Maliq

Fermerët e fushës së Maliqit janë duke përfunduar vjeljen e qepës, një ndër kulturat kryesore që ata prodhojnë.

Ky vit ka qenë i favorshëm për të siguruar një produkt cilësor pasi lagështia e tezgjatatur e pranverës ka bërë që toka të kishte prani të ujit, çka ndihmon në rritjen e kësaj kulture.

Drejtori i Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Arben Dulellari thotë se fermerët e zonës kanë fituar tashmë një eksperiencë në ku-

tivimin e qepës për të siguruar një prodhim cilësor, kjo duke përdorur edhe metoda të ndryshme për mbjelljen e saj.

Dulellari shton më tej se edhe përdorimi i mjeteve që kryejnë procese të ndryshme, e

ka lehtësuar punën e fermerit

Në fushën e Maliqit fermerët kanë mbjellë një sipërfaqe prej mbi 700HA me qepë. Zonat më potenciale për prodhimin e saj janë fshatrat e Njësisë Pojan dhe Pirg



## INOVAÇION

## Modernizoi impiantet e përpunimit me mbështetjen e AZHBR, Denaj: Fabrika në Boboshticë grumbullon qumësht nga 1 mijë blegtorë

Tani rreth 1000 blegtorë të zonës së Korçës, falë kontratave të biznesit kanë një vend të sigurt për qumështin e tyre në fabrikën "SHAKA" Boboshticë, e cila së fundmi ka modernizuar impiantet e përpunimit me mbështetjen e qeverisë.

Boboshticë, që prodhon deri në 3 tonë djathë të bardhë e 300 kg kaçkavall në ditë.

Si përfitues i investimeve përmes Skemës Kombëtare nga AZHBR, Jani ka rritur cilësisht teknologjinë dhe sot në këtë fabrikë përpunohen rreth 20

urisë ushqimore.

Industria e agropërpunimit është një ndër sektorët me potencial të madh në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Ky sektor kryeson me një sërë investimesh të rëndësishme në të gjithë nënsektorët e saj, nga përpunimi i qumështit, mishit, fruta-perimeve etj., duke sjellë një standard të ri zhvillimi në prodhime cilësore dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Investimet në makineri dhe pajisje të teknologjisë së lartë me mbështetjen e programit IPARD II, kanë sjellë rritje të standardeve dhe kapaciteteve prodhuese, duke synuar përveç tregut vendas, edhe atë të jashtëm, krahas ndikimit në rritjen e të ardhurave në ekonominë rurale dhe nxitjen e punësisht.

Qëllimi i këtyre investimeve është arritja e standardeve evropiane të cilësisë dhe garantimi i sigurisë ushqimore në çdo halkë të zinxhirit ushqimor, si dhe rritja e punësisht dhe zhvillimi i zonave rurale.



Kështu u shpreh ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj gjatë vizitës që zhvilloi në fabrikën e përpunimit të qumështit "SHAKA", e ngritur me punën e palodhur të Jani dhe Aleksandër Shakës në

tonë qumësht në ditë.

Denaj u shpreh se, me mbështetjen e programeve të qeverisë, fabrika ka përmirësuar teknologjinë e përpunimit, standardizuar cilësinë dhe garanton parametra të larta të sig-

## Studenti veterinar që studion në Tiranë nuk harron fermën e familjes. Vilson Zela: Çdo fundjavë në Kukës, punoj në tokë e stallë. Keqardhje që blegtoaria po braktiset

*Një histori frymëzuese është ajo që nga vjen nga fshati Bushati i Kukësit, ku një i ri vetëm 22 vjeç ka zgjedhur të studiojë mjekësinë veterinarë dhe fundjavave të përkushtohet fermës së familjes. Vilson Zela, përveç mbarësishtimit të bagëtive, kultivon dhe 50 dylm tokë në pronësi të familjes*

Vilson Zela 22 vjeç, nga fshati Bushat i Kukësit është ndër të paktët studentë të mjekësisë veterinarë.

Në fillim kur zgjodhi këtë degë, kishte frikë se do gjykohej, por sot, në vitin e katër të studimeve në Universitetin Bujqësor të Tiranës, është shumë i lumtur që po ndjek gjurmët e babait të tij, i cili ushtron profesionin e veterinerit prej 40 vitesh.

"Unë jam student i mjekësisë veterinarë në vitin e katërt. Studioj në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Kam bërë zgjedhjen e duhur që kam zgjedhur atë degë. Nga mentaliteti i zonës, kisha ca pikëpyetje, frikë. Të gjithë e mendojnë si një profesion të rëndomtë. Por, që kur vajta në fillim e kuptova që kam bërë zgjedhjen e duhur. Është një profesion i nderuar dhe respektuar. Tre vitet e para kanë të bëjnë me formimin e përgjithshëm. Në vitin e katër trajtojmë sëmundjet e kafshëve. Mund të bëjmë skemat e kontrollit të përgjithshëm. Gjëra bazike momentalisht, por ky vikt është vendimtar. Arrimë e fusim këmbët tamam në profesionin tonë. Kam parë disa sëmundje tek kafshët. Kam marrë pjesë në lindje të kafshëve. Jemi një fakultet që studion të gjitha kafshët", tha i ri.

Atë që mëson në leksion, i riu e vendos në praktikë çdo fundjavë në fermën e familjes

së tij në Kukës.

Ditën e nis me pastrimin dhe ushqimin e bagëtive në stallë.

Më pas, u përkushtohet 50 dylm tokë, në të cilat familja e tij

është tregu i shitjes. Ka produkt të një cilësie shumë të mirë, por nuk ka shitje. Ose çmimi është përtokë. Kur produkti jonë del në tre, tregu është i mbushur. Kemi



kultivon të gjitha llojet e produkteve bujqësore, nga gruri, misri, patatja, lakra e perimeve të tjera.

Klima dhe dalja vonë e prodhimit, janë në disfavor të fermës për shkak se tregu është i mbushur me prodhime nga Myzeqeja. Megjithatë kjo nuk e bën aspak pesimist.

"Është fundi i prodhimit. Vetëm kultura e lakrës arrin temperaturën. Fill pas patates dhe qepës, ne përgatisim kulturën e dytë që është lakra. Ka lakra që arrinë deri në 7-8 kg. Më kryesorja është sigurimi i tregut. Kemi arritur ta krijojmë mallin, por problemi që hasim çdo vit

pleh organik", tha Vilsoni.

Më tepër keqardhje Vilsoni shpreh që çdo vit e më shumë njerëzit po braktisin fshatrat, heqin dorë nga bujqësia dhe mbarësishtimi i gjedhëve.

"Personalisht mua më pëlqejnë kafshët e mëdha. Kafshët e prodhimit. Gjedi ka një rëndësi shumë të madhe se është burimi kryesor i qumështit. Është një kafshë që ja vlen të investohet. Një frikë e madhe si një veteriner është që ka rënë numri i fermerëve, krerëve. Kanë hequr dorë nga kafshët. Në të gjitha shtetet fermerët subvencionohet. Ka nevojë për një dorë të fortë", tregoi i riu.

## "Laboratori i Inovacionit", nxitje zhvillimit të qëndrueshëm të agroturizmit

Në bashkëpunim me Shoqatën e Agroturizmit, GIZ mbështeti krijimin e "Laboratorit të Inovacionit".

Ky projekt përbëhet nga një seri me workshop-e të organizuara për anëtarët e shoqatës së agroturizmit mbi tema të ndryshme inovative që lidhen me menaxhimin e agroturizmit.

Qëllimi i tyre është të sjellin risi në agroturizëm dhe të rrisin përfitimin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të operacioneve të sektorit.

Workshop-i i organizuar së fundi u fokusua në krijimin e sapunëve dhe shampove artizanale e miqësore me mjedisin, për të rritur cilësinë e përvijës turistike dhe për të diversifikuar burimet e të ardhurave.

Ky seminar i parë ishte një eksperiencë e frytshme për

Duke nisur nga marketingu online e deri te risitë në kuli-



pjesëmarrësit dhe në vijim synohet të krijohen produkte të tjera që i shërbejnë agroturizmeve.

nari dhe dixhitalizim, workshop-et e radhës do të zhvillohen çdo dy muaj deri në fund të Shtatorit 2024.

## Regjistri i fermerit, instrumenti i ri që nxit fomalizimin dhe sigurinë ushqimore

Regjistri i Fermerit është instrumenti i ri në dorë të fermerëve për të mundësuar protokolle dhe gjurmueshmëri të prodhimit cilësor bujqësor për konsumatorët, për të qenë më të sigurtë në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

FAO në Shqipëri po trajnon stafin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe përfaqësuesit e shërbimit të ekstensionit të përfshirë në procesin pilot të mbledhjes së të dhënave FADN (Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave).

Të dhënat e mbledhura nga 40 ferma do të ngarkohen në shpejti në serverin EU RICA 1.

Të dhënat e FADN do të ndi-



hmojnë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për analizat e politikave dhe vendimmarrjen

bazuar në të dhënat aktuale, të cilat do të formësojnë të ardhmen e sektorit të bujqësisë.

## Përfundon investimi për mbrojtjen nga lumi Dunavec, Denaj: Eliminohet përmbytjen e tokës bujqësore

Përfundimi i punimeve në argjinaturën për mbrojtjen nga lumi Dunavec, në fshatin Ravonik në Korçë, parandalon

e investimit për mbrojtjen nga lumi Dunavec, me vlerë 16 milionë lekë të financuar nga qeveria shqiptare.

janë realizuar në zbatim të protokolleve teknike, me tre rreshta, nga të cilat 1 me gabion dhe 2 me beton.

Ministrja u shpreh se "ky investim eliminon rrezikun e përmbytjes nga prurjet e lumit për 12 hektarë tokë bujqësore dhe rrugën lidhëse të parcelave".

Në prag të stinës së dimrit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përmes Bordeve të Ujitje Kullimit, ka ndërhyrë në një sërë veprash të infrastrukturës ujitëse dhe kulluese, apo në argjinaturat e lumenjve në disa zona të vendit, me qëllim rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e tyre, për t'i paraprirë parandalimit të përmbytjeve në tokat bujqësore nga reshjet e shiut.

Ndërkohë që puna vijon në këtë sektor me një sërë investimesh të tjera në shërbim të komunitetit.



problematikën e përmbytjeve të tokave bujqësore në këtë zonë.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj inspektoi nga afër realizimin

Gjatë inspektimit, e shoqëruar edhe nga kryetari i bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo dhe ekspertët e fushës, Denaj u informua se, punimet për infrastrukturën mbrojtëse

KËNDI I EKSPERTIT

Plehërim natyral me bimën Komfrej (Symphytus officinalis)

Prof. Ass. Dr. Enver Isufi

Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Të gjitha bimët pasi kalben kthehen në pleh. Ato i rikthj...

Ka disa bimë të cilat kanë cilësi të veçanta. Ato grumbullojnë në trupin e tyre shumë...

Një ndër këto bimë është edhe bima Komfrej, e cila mban emrin latinisht (Symphytus officinale).

Kjo bimë është e sjellë për herë të parë në Shkodër nga fondacioni OXFAM.


Është përdorur fillimisht nga shoqata e përmikulturës atje në Shkodër, e drejtuar nga kolegu ynë agronom Tofik Fugarinaj.

Sot përdoret nga Ferma Ekologjike "UKA" në Laknas, Tiranë. Disa bimë për burim fidanash ndodhen edhe në Institutin e Bujqësisë Biologjike, në Shkozë, Durrës.

Është një bimë shumëvjeçare me rrënjë në formë tuberash të stërzgatur si shkopi.

Lëndët ushqyese për të cilat bimët kanë nevojë për zhvillimin e tyre jetësor ndahen tre grupe:

- Elementë kryesorë Azot (N), Fosfor (P), Potas (K).
• Elementë dytësorë Kalcium (Ca), Magnez (Mg), Squfur (S)
• Elementë ushqyese që përdoren nga bimët me sasira të vogla, ose mikroplehra/mikroelementë, si hekuri, magnezi, zingu, bakri, molibli, klori (Fe, Mn, Zn, Cu, Mo, Cl)



Përmbajtja e lëndëve ushqyese te bima Komfrej

• Bima Komfrej është e pasur me Azot (N), Fosfor (P) Kalium/Potas (K)

• Është shumë e pasur me proteina, konkretisht ka 22-33 %

• ka Vitamina A, C, B-12

• E pasur me Silikon, Kalcium, mikroelementë

• Përdoret si ushqim i mirë edhe për kafshët. Kjo bimë ia kalon edhe bimës së sojës për përmbajtjen e proteinave deri në 20 herë.

Siç shikohet komfrej konkurron me plehun organik të stallës prodhuar nga bagëtitë, madje ka tregues edhe më të mirë se sa plehu organik.

Komfrej është ndër bimët më të hershme e përdorur si bimë, e cila kuron shumë sëmundje në njerëz dhe në kafshë.

Prodhom volum të madh biomase si ushqim për kafshët dhe për përgatitje ilaçesh.

"Komfrej është e vetmja bimë që e merr dhe akumulon nga toka vitaminën "B-12"

Cilësitë botanike dhe metodat e shumimit

Bima komfrej është një bimë shumëvjeçare. Sistemi rrënjor është në formë tuberësh në formë boshtore.

Gjethet janë të gjata si gjethet e bimës së duhanit, por më të ngushta.

Ka gjethë të gjatë mbi 20 cm. Një bimë nxjerr disa lastare vëllezër në formë tufe lastarësh.

Shumimi: Bima shumohet me rrënjët e saj të cilat kanë ose lastarë të rinj, ose sytha të gatshëm të nxjerrin lastarë të rinj.

Bima mund të shtohet edhe me fidana. Priten shishet plastike të ujit deri në lartësinë 15

Si përdoret si pleh lëngu i nxjerrë nga gjethet e bimës komfrej.

Lëngu i përqendruar, hollhet me ujën në raport 1 kg koncentrat me 10 litra ujë. Me këtë

Përmbajtje e elementëve ushqimorë kryesorë në bimën e komfrej. (S.officinale)

Table with 5 columns: Material, Ujë %, Azot (N) %, Fosfor (P) %, Potas (K) %, Raporti Karbon: Azot. Rows include Plehu stallës nga bagëtitë, Bima Komfrej, and Kompostimet nga mbetjet bimore.

cm, mbushen me dhe (tokë) dhe në to futet një copë rrënjë me sytha të bimës Komfrej.

Rrënjëzat mund të mbillen në vjeshtë dhe janë gati të mbillen në pranverë.

Distancat e mbjelljes: Bimë mbillet në distanca rreshti nga rreshti 60 - 70 cm dhe 50 cm bima nga bima.

Kur bima mbillet për qëllime të prodhimit industrial të lëngut të ekstraktit bimor, mbillet në sipërfaqe të mëdha.

Bima komfrej si pleh përdoret në disa forma:

Prodhim lëngu nga ekstraktimi i gjetheve në enët me ujë, prodhim i gjetheve për plehërim të gjelbër, përdorimi i gjetheve dhe lëngut për nxitjen e proceseve të kalbëzimit në kavaletat e kompostimeve të mbetjeve organike në fermat

bujqësore.


Prodhimi i lëngut të ekstraktit nga bimës së Komfrej për qëllime plehërimi

Për fermat e vogla përdoren fuçi 200-litërshe, të cilat mbushen me ujë. Në këtë fuçi futen 10-15 kg biomase nga bima komfrej.

trësisë spërkaten bimët bujqësore. Kjo tretësisë mund të përdoret për ujitjen e bimëve.

Bima komfrej mund të përdoret edhe si plehërim i gjelbër. Në pemëtore dhe ullishte mund të mbillen 2-3 bimë komfrej për çdo pemë frutore ose bimë ulliri.

Në foto: Pamja nga bimët komfrej. 1. gjethet, 2. lulet, 3. rrënjët, 4. përgatitja e ekstraktit, 5. marrja e lëngut të ekstraktuar.



"Festa e Gështenjës" në Bajram Curri, Jaupllari: Mbështetje produkteve që nxisin ekonominë lokale

Në qytetin e Bajram Currit, Tropojë, u organizua "Festa e Gështenjës", me fokus promovimin e produkteve të zonës, si

dor, fermerë dhe sipërmarrës që merren me grumbullimin dhe përpunimin e gështenjës në këtë zonë, si dhe vizitorë e të ftuar të

rëndësishëm i sektorit të bujqësisë dhe objektivi ynë është rritja e prodhimit dhe e të ardhurave të fermerëve që punojnë me këtë produkt", tha Jaupllari.

Në kuadër të kësaj feste u organizua dhe panairi me produktet ushqimore tradicionale të prodhuara me gështenja, që ngjalli interes të veçantë për pjesëmarrësit.

Po ashtu, bizneseve të zonës iu krijua mundësia që të promovojnë gatimet e tyre tradicionale, punimet artizanale si dhe të vendosin kontakte për shitjen e prodhimeve të zonës në tregje të reja.

Ekosistemi i gështenjave të Tropojës është më i madhi në Ballkan. Ai përbëhet nga një kultivar me vlerat larta biogjenetike dhe përveç ndikimit në ekonominë lokale të zonës, masivi i Gështenjave të Tropojës është edhe një atraksion për turistët e natyrës.



aset potencial për zhvillimin e ekonomisë lokale.

Të pranishëm në këtë event, ishin zv/ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Arjan Jaupllari, deputetë të qarkut, përfaqësues të pushtetit ven-

shumë që iu bashkuan festës.

Jaupllari u shpreh se mbetet prioritet promovimi i prodhimeve lokale për rritjen e pranisë së tyre në tregje dhe fuqizimin ekonomik të fermerëve.

"Gështenja është aset i

Matrikullimi i kafshëve, Denaj: Me rëndësi për sigurinë ushqimore dhe formalizimin e blegtorisë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në fokus forcimin e kontrollit dhe garantimin e sigurisë ushqimore në tregjet e vendit për sektorin blegtoral.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ministrja Anila Denaj informoi se Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve vijon me matrikullimin dhe gjurmimin për shëndetin e kafshëve bujqësore.

Gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti, janë kryer 348 000 matrikuj të rinj. Ndërsa janë matrikulluar 43 105 gjedhë; 303 700 të imta; 1 389 derra.

Denaj tha se, "matrikullimi i krerëve vijon në çdo fermë nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Ky është një proces i rëndësishëm për shëndetin e kafshëve, sigurinë ushqimore dhe formalizimin e blegtorisë".

Matrikullimi i kafshëve në fermë është detyrim ligjor për

çdo mbarështues. Është një proces që kryhet falas dhe i jep mundësinë blegtorëve të përfi-

është hapi i parë i formalizimit të sektorit blegtoral, i cili siguron gjurmueshmërinë e shën-



tojnë shërbime falas nga Shërbimi Veterinar dhe subvencione nga shteti nëpërmjet Skemës Kombëtare të Mbështetjes.

Ministrja tha se identifikimi individual i kafshëve dhe regjistrimi i fermave në regjistrin blegtoral nga veterinerët e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

detit të kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore.

Në funksion të rritjes së shërbimit veterinar sipas standardeve më të mira, janë punësuar së fundmi edhe 400 veterinerë të rinj me shtrirje në të gjithë vendin, me qëllim forcimin e kontrollit në fermat blegtorale.

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji nëntor 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçoollari

Pamja e qiellit gjatë muajit Nëntor 2023

Më 3 nëntor - Jupiteri në opozitë. Planeti gjigand do të jetë në distancën më të afërt

Parashikimi i motit për muajin nëntor 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi D, N), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli.

Parashikimi i motit për nëntor 2023 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi D, N), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli.

me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli. Do të jetë më i ndritshëm se çdo kohë tjetër të vitit dhe do të jetë i dukshëm gjatë gjithë natës.

Më 4, 5 nëntor - Shiu meteorik i Tauridit. Tauridët janë një shi i vogël meteorësh që zgjat gjatë dhe prodhon vetëm rreth 5-10 meteorë në orë.

Më 17 dhe 18 Nëntor - Shiu meteor i Leonids. Leonidët janë një shi mesatar, që prodhon deri në 15 meteorë në orë në kulmin e tij.

Më 13 nëntor - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës.

Më 13 nëntor - Urani në opozitë. Planeti blu-jeshile do të jetë në distancën më të afërt me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli.

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit nëntor 2023

Table with columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë. Rows include temperature, precipitation, wind speed, etc.

Do të jetë më i ndritshëm se çdo kohë tjetër të vitit dhe do të jetë i dukshëm gjatë gjithë natës.

Më 17 dhe 18 Nëntor - Shiu meteor i Leonids. Leonidët janë një shi mesatar, që prodhon deri në 15 meteorë në orë në kulmin e tij.

Më 13 nëntor - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës.

Më 13 nëntor - Urani në opozitë. Planeti blu-jeshile do të jetë në distancën më të afërt me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli.

shfaqje e mrekullueshme herët në mëngjes. Shikimi më i mirë do të jetë nga një vend i errët pas mesnate.

Më 27 nëntor - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar.

Parashikimi i motit për muajin nëntor 2023

Nëntori në Tiranë do të jetë i ndikuar nga klima bregdetare mesdhetare. Kur udhëtoni për

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin nëntor 2023

Table with columns: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %, Dita), Shenjat Astrologjike.

në Tiranë në nëntor, mund të prisni: herë pas here mjegull, shi të zakonshëm, stuhi të herëpashershme dhe mot më të freskët.

Temperaturat e larta ditore do të ulen me 5°C, nga 19°C në 14°C, rralë duke rënë nën 10°C ose duke kaluar 23°C.

Për referencë, më 3 gusht, ditë të ndriçuara dhe shi të rënda.

tojtë ditë jo edhe aq të nxehta me një qiell me vranësira të forta.

Temperaturat e ulëta ditore do të ulen me 4°C, nga 7°C në 4°C, rralë duke rënë nën -2°C ose duke kaluar 12°C.

Për referencë, më 3 gusht, ditë të ndriçuara dhe shi të rënda.

dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18° C në 32° C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga 0° C në 11° C.

Zhvillimi i reve

Muaji nëntor në Tiranë do të përfjetojë një rritje graduale të mbulimit të qiellit me re, ku përqindja e kohës që qielli është me vranësira ose kryesisht vranësira rritet nga 46% në 54%.



KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji nëntor 2023

(Vijon nga faqja 14)

Kalendari i ditëve më të mira të muajit nëntor 2023 për disa aktivitete të përditëshme të fermerit

Table with 2 columns: Data, Punët dhe aktivitetet që mund të kryhen. It lists daily agricultural tasks and activities for the month of November 2023.

gjëndjen shpirtërore. Mekanizmat që funksionojnë në natyrë ndikojnë në qënien njerëzore, e cila është pjesë përbërëse e botës që na rrethon. Për të kuptuar më mirë realitetin rreth nesh dhe për të përshtatur ritmin e punës dhe të jetës sonë, duhet të kemi njohuri të mjaftueshme për këto fenomene, të cilat kanë ndikimin më të madh në këto procese.

Hëna ndikon jo vetëm në rritjen dhe zhvillimin e bimëve por dhe në veprimtarinë jetësore dhe të përditëshme të qenieve të gjalla. Sipas traditës mendohet se kur hëna është në fazën e duhur dhe vendin e duhur në zodiak, besohet gjërësisht se aktivitetet do të jenë më të frytshme apo të çojnë në rezultate të mira. Periudha në mes të hënës së re dhe të plotë (çereku i parë dhe i dytë i hënës), konsiderohet si koha më e mirë për të kryer detyrat që kanë lidhje me forcën, pjellorinë dhe rritjen. Periudha mes Hënës së plotë dhe hënës së re (çereku i tretë dhe i katërt i hënës), është koha më e mira për korjet, rritjen e ngadalësuar, etj. Merret në konsideratë edhe për marrëdhënien që ka Hëna me 12 shënjat sunduese të zodiakut.

Kështu në bazë të kombimeve dhe marrëdhënieve të Hënës me trupat qiellorë që shprehen në shënjat zodiakale, përcaktohet në një farë mase ndikimi dhe rezultati i këtyre

veprimtarive.

Kalendari hënor i të ushqyerit të njerëzve për muajin nëntor 2023

Mendohet se Hëna ka ndikim në të ushqyerit e njeriut. Dieta bazohet në idenë se Hëna ndikon mbi ujën në trupin tonë, ashtu siç ndikon në baticat në oqean. Pra, kjo fuqi mund të shfrytëzohet për të ndihmuar dikë të humbasë peshë. Duke qenë se tërheqja e Hënës është më e madhe gjatë hënës së plotë dhe asaj të re, një dietë e lëngshme gjatë këtyre ditëve do të ndihmojë në humbjen e peshës.

Hëna e plotë gjithashtu mund të na prishë oreksin. Gjatë gjumit të thellë, ne prodhojmë më shumë një hormon të quajtur leptin, i cili na ndihmon të ndihemi të ngopur dhe të kënaqur. Ndërkohë, grelina, e cila ka efekt të kundërt, nxitës të urisë, zbrit. Një arsye tjetër pse mund të ndihemi më të uritur është fakti se ne prodhojmë më pak leptinë kur ka një hënë të plotë.

Në Indi besohet se ngrënia gjatë eklipsit hënor është e dëmshme për shëndetin, dhe kjo është thyeshit sepse eklipsi çon në emetimin e rrezeve të forta ultravjollcë, të cilat ndikojnë në ushqimin e gatuar, i cili përgatitet me ujë, i cili tërheq më tej emetimet, gjë që e kthen ushqimin e gatuar në helm.

Në këtë pjesë jepen rekomandime për ushqimin e përditshëm të njerëzve, duke patur parasysh drejtimit kryesor të ushqimit ditë të njeriut. Kjo bëhet duke u bazuar dhe në fazat e Hënës dhe marrëdhënieve të tyre me shënjat e Zodiakut.

Kalendari hënor për shëndetin dhe bukurinë e grave fermere nëntor 2023

Ndikimi i trupit qiellor në biologjinë e njerëzve ishte hedhur poshtë kryesisht si mit, por disa studime të fundit kanë lidhur fazat hënore me gjumin dhe gjëndjen shpirtërore të njeriut. Hëna mund të ndikojë në qarkullimin limfatik të njeriut.

Trupi dhe lëkura forcohen dhe zbukurohen gjatë hënës në rritje. Përbërësit aktivë në kremra përthithen mirë në lëkurë dhe e bëjnë lëkurën të shkëlqejë. Përbërësit aktivë të kremrave dhe produkteve të tjera të kujdesit të lëkurës nuk absorbohen shumë mirë në trup dhe lëkurë gjatë hënës së rënies. Lëkura është shumë më e ndjeshme në kohën e hënës në rritje. Për shkak se trupi është në gjendje të thithë më shumë lëndë ushqyese gjatë hënës në rritje, lëkura gjithashtu përfiton nga kjo dhe ajo zakonisht duket më e shëndetshme. Meqenëse gjatësia mesatare e cikleve menstruale të grave përputhet me ciklin e rritjes dhe zbehjes 29.5-ditore të hënës, shumë kultura e lidhin hënën me pjellorinë.

Table with 2 columns: Data, Përshkrimi i veprimeve që do të kryhen gjatë ditës. It lists specific health and beauty tips for women during the month of November 2023.

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe  
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,  
BËHET!*



 **CREDINS bank**

[www.bankacredins.com](http://www.bankacredins.com)

Tel.: +355 4 53 53 000

